REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 952 /20
Datë/Datum. 30. 11. 2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Ekspert Shqyrtues, Agim SHEQIRI Nënshkrimi	Data e autorizimit të ekspertit 20.11.2020	Data e dorëzimit të raportit 30.11.2020	Nr. i lëndës: 952/20

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 16.11.2020 Operatori Ekonomik: "PRO ACC Group" SHPK–Prishtine parashtron ankesë në OSHP me nr. prot. 952/20 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Vlerësimi i aseteve te Trainkos" Sh.a me nr prok 10908-20-4910-2-2-1 i udhëhequr nga NP"TRAINKOS" SHA

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë për të hapur , vlera e parashikuar e kontratës: 35,000.00 €

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

- Neni 59 i LPP-së Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.
- Nenin 72 të LPP-së.

- Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Kompania jone si kompani lider dhe me një eksperiencë shumë vjeçare për vlerësim dhe ri-vlerësim të pasurive dhe aseteve ka shprehur interesim që të marrë pjesë në këtë aktivitet të prokurimit dhe me date: 03.09.2020 kemi tërhequr dosjen e tenderit në platformën elektronike e-prokurimi

Me datë 03.11.2020 kemi pranuar Letër standarde për tenderuesin e eliminuar si dhe me datën 11.11.2020 kemi pranuar Vendimi për Refuzimin e kërkesës për rishqyrtim përmes platformës elektronike e-prokurimit ku thuhet se:

Operatori Ekonomik: "PRO ACC Group" SHPK–Prishtine pjesëmarrës në ftesën për ofertë parashtron ankesë ne OSHP me nr. prot. 952/20 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Vlerësimi i aseteve te Trainkos Sha me nr prok 10908-20-4910-2-2-1 i udhëhequr nga NP"TRAINKOS" SHA

Pretendimi i AK-së në letrën për tenderuesit e eliminuar:

Sa i përket personit të prezantuar me numër rendor 1, mbi kërkesat e projekt menaxherit dhe përvojën e punëspas diplomimit.

Përgjigja e OE: Sa i përket, Menaxherit të Projektit, personi në fjale provoja e punës i njihet duke filluar nga data e Diplomimit në Fakultetin Ekonomik në Drejtimin Banka, Financa dhe Kontabilitet nga data; 18 Mars 2008, Nr. 515, dhe ka 10 vite eksperiencë.

Ndërsa sa i përket kriterit Ekonomist i Diplomuar, i njëjti e plotëson kriterin e lartë përmendur pasi që personi në fjale e ka të përfunduar, Master në Fakultetin Ekonomik me Titull: Master për Banka, Financa dhe Kontabilitet ka te përfunduar me datën: 8 korrik 2014 i ka të dëshmuara dhe me CV dhe Deklaratë me shkrim se personi në fjalë ka mbi 10 vite eksperiencë pune (nga viti: 2008 deri me tani është me kontratë pune të rregullt), që të gjitha kanë qenë të ngarkuar në e-prokurim sipas numrit rendor, për të njëjtën pika AK ka pasur mundësi të na kërkoj sqarime shtesë.

AK këtë pikë e ka hedhur poshtë me Vendim. Nr. 4911/2020

- Pretendimi i AK-së në letë për tenderuesit e eliminuar te pika 2 për Asistent

Menaxher i Projektit. Sa i përket personit të prezantuar me numër rendor 2, ju nuk e keni plotësuar kërkesat e dosjes se tenderit për Asistentin e Projekt menaxherit të diplomuar në fushën e financave apo kontabilitetit.

Përgjigja e OE: Sa i përket personit në fjale është prezantuar DIPLOMA e Fakultetit ku personi në falë ka përfunduar Studimet në Drejtimin Ekonomist i Diplomuar. Me datë 21.03.1989 Nr. 5145.(në atë kohë nuk ka pasur degë të ndara, vetëm Ekonomistë Diplomuar personi në fjalë ka përfunduar studimet para sistemit të Bolonjës ku nuk ka pasur drejtime te ndara dhe ka marrë Titullin Ekonomist i Përgjithshëm për të gjitha lamit e ekonomisë).

- Prendentimi i AK-së në Vendimin ine Ni\ 4911/2020 të datës 11.11.2020 për Asistentin e Projekt menaxherit:

OE duhet të caktojë një Asistent të projekt menaxheri i cili duhet të jetë i diplomuar në fushën e biznesit ndërkombëtar me provoj profesionale prej 5 viteve pas diplomimit në fushën e financave dhe duhet të jetë anëtar i ndonjë organizate të licencuar për kontabilitet publik.

Përgjigja e OE: Te pika e lart cekur te AK- së nuk qëndron per arsyeje se AK i ne datën 14.09.2020 ka ndryshuar Dosjen e Tenderi përmes Njoftimit për Informata Shtesë ose

pika 3 të Kapaciteti Teknik dhe profesional ku thuhet që:

OE duhet të caktojë një Asistent të projekt menaxherit i cili duhet të jetë i diplomuar në fushën e financave apo kontabilitetit me përvojë profesionale prej 5 viteve pas diplomimit ne fushën e financave dhe duhet te jetë anëtar i ndonjë organizate te licencuar për kontabilitet publik.

Përgjigja e OE: I njëjti ka të përfunduar SCAAK nga Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës, ku i njëjti person posedon Certifikatën e anëtarësisë në SCAAK, që të gjitha i ka dhe të dëshmuar ne CV dhe Vendim për Asistent i Projekt Menaxherit, ku kanë qenë të ngarkuar në e-prokurim sipas numrit rendor.

Personi në fjalë ka /mbi 5 vite kontratë pune (tejkalon eksperiencën e kërkuar) të rregullt në fushën e financave apo kontabilitetit publik.

Ne OE e kemi plotësuar këtë kriter ku dhe mund te shihet në të dokumentet e ngarkuar në e-prokurim

Përgjigja e OE: Sa i për ket pretendim te AK NR.3 Ne OE kemi dorëzuar listën të vulosur te nënshkruar me 17 kontrata ku të gjitha këto kontrata janë kontrata me vlerësim dhe ju kemi prezantuar që të gjitha Kontrata dhe Referencat si dhe ku kemi sqaruar për se cilin vlerësim sa ka qenë vlera e raportit të vlerësimit (Pasurive të luajtshme dhe të pa luajtshme) ku kemi prezantuar Kontrata, Referencat, Raportet mbi verën e shumës më shume se sa është kërkuar në DT, ku dhe janë prezantuar edhe raportet e vlerësimit ku ceket shuma e vlerësuar si dhe janë prezantuar linqet e Autoriteteve Kontraktuese për qarkullimet vjetore të kompanive publike linqet e tyre dhe raportet e pasqyrave financiare te këtyre kompanive

Pretendimi i AK që mohon shumen e referencave të kontratave publike dhe private është e pa saktë për arsye se

Kontrata publike kanë lëshuar referencë me shumë të kontratave e cila dëshmon mbi kënaqsh mërinë e shërbimeve tona

Ne si OE kemi bashkangjitur edhe pjesën e raporteve të vlerësimit ku ceket edhe vlera e pasurisë së vlerësuar si dhe kemi listuar veç e veç listën me të dhëna për së cilett referencë për shumat e vlerësuar, si dhe shumen e qarkullimit vjetor të kompanive dhe linçet e WEB SITEVE të tyre.

Këto fakte dhe argumente mund të shihen tek Auditimi i pasqyrave Financiare për 3 vitet e fundit të K.U.R Prishtina , K.R.U Hidroregjioni Jugor SHA Prizren, dhe K.R.U Gjakova. Ku kanë qenë të gjitha të ngarkuar në e-prokurim sipas numrit rendor

Po ashtu në këtë rast AK ka mund të sqaroj këtë në bazë të nenit 72 te LPP por i njëjti AK nuk ka qenë i interesuar të respektoj nenin 72 të LPP-së, por ka vepruar me qëllim apo me dashje të analizimit të Ofertës tonë, sepse ne i plotësojmë të gjitha

kriteret e kërkuara

Si perfundim kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit qe të merret një Vendim i drejtë ne mënyrë qe mos të diskriminohemi ne apo Operatoret tjerë Ekonomik qe janë të specializuar për këtë fushe

KRITERET PËR VLERËSIM

Çmimi me i ulet

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Sipas raportit të komisionit vlerësues Operatori Ekonomik "PRO ACC Group" ka caktuar menaxherin e projektit i cili nuk përmbush kërkesën për përvojën profesionale prej 10 viteve pas diplomimit me titull ekonomist i diplomuar.
Arian Shala i caktuar si menaxher i projektit diplomën Baçeler e ka marr në vitin 2008 ndërsa mastar në vitin 2014 që do të thotë se nuk për mbush kërkesat e dosjes se tenderit.

Asistenti i Projekt Menaxherit nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit sepse nuk është i diplomuar ne fushën e kontabilitetit dhe financave por është në Ekonomikat e OPB-se.

Operatori ekonomik "PRO ACC Group" ka ofruar listën e referencave për vlerësim te aseteve te kompanive me vlere deri në 3 milion Euro ne te cilën nuk ka përfshirë asnjë vlerësim qe behet për atë kompani por për banka qe marrin kolateral nga huamarrësit. Dy kontratat GIZ dhe Hidroregjioni jugor nuk ka përfshirë ne reference vlerën e aseteve.

Operatori Ekonomik nuk ka përfshirë referenca për vlerësimet e bashkangjitura ne projektet KRU Prizreni,Prishtina dhe Gjakova

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

N/A

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "Pro ACC Group"SHPK

Operatori Ekonomik: "PRO ACC Group" SHPK–Prishtine pjesëmarrës në ftesën për ofertë parashtron ankesë ne OSHP me nr. prot. 952/20 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Vlerësimi i aseteve te Trainkos Sha me nr prok 10908-20-4910-2-2-1 i udhëhequr nga NP"TRAINKOS" SHA

Përgjigje në Pretendimet ankimore:

Eksperti Shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor 1 dhe 2 është i pabazuar ndërsa pretendim nr. 3 i bazuar për arsye se:

Tek kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale (pretendimi nr. 1) është kërkuar që Operatori Ekonomik duhet te caktoje një Menaxher të Projektit i cili duhet te jetë ekonomist i diplomuar në fushën e kontabilitetit apo financave dhe përvojë profesionale prej 10 viteve pas diplomimit në fushën e financave , bankave dhe kontabilitetit dhe kjo të dëshmohet me kopje të diplomës dhe CV, dhe për ketë kërkesë të Kualifikimit OE ankues nuk ofron dëshmi 10 vjeçare sepse menaxheri i projektit (Arian Shala) ofron diplomë për Baçeler i diplomuar në vitin 2008, ndërsa gradën mastar drejtimi banka financa dhe kontabilitet e ka përfunduar ne vitin 2014 që do të thotë se një kërkesë e tillë nuk është përmbushur.

Tek pika tre (3) e kapacitetit teknik dhe profesional është kërkuar një asistent i menaxherit të projektit i cili duhet te jetë i diplomuar në fushën e financave apo kontabilitetit me përvojë profesionale prej 5 viteve dhe duhet të jetë anëtar i ndonjë organizate të licencuar për kontabilitet publik.

Sipas dëshmimeve asistenti i projekt menaxherit posedon diplomë se ke përfunduar fakultetin ekonomik por jo drejtimi banka dhe financa por drejtimi ekonomika e OPB-së qe do te thotë se kualifikimin qe posedon asistenti i projekt menaxherit nuk është ne përputhje me kërkesat e dosjes, ndërsa sa i përket vlerësimit te AK-së se asistenti i projekt menaxherit nuk është anëtar i ndonjë shoqate për kontabilitet publik nuk qëndron pasi që dëshmitë flasin se asistenti i Menaxherit të Projektit z Emin Sylejmani është anëtar i Shoqatës së kontabilisteve dhe Auditorve te certifikuar dhe njëkohësisht është i certifikuar si kontabilist.

Pretendimi ankimor nr. 3 i parashtruar nga OE ankues është i bazuar për faktin se OE Ankues ofron dëshmi dhe referenca të mjaftueshme dhe në përputhje me kërkesat e dosje së tenderit Sipas kërkesave kualifikuese Operatori Ekonomik duhet te dorëzojë se paku dy referenca dhe raporte te vlerësimit për vlerësim te aseteve në kompani të mëdha me vlere te aseteve minimum 3 milion €uro si dhe Operatori Ekonomik duhet te dorëzojë se paku 2 referenca dhe raporte të vlerësimit për vlerësim te aseteve të kompanive te mëdha me qarkullim jo me pak se 7.5 milion në tri vitet e fundit

Ne listën e kontratave te realizuara OE ankues ofron dëshmi se ka realizuar kontrata për vlerësim te pasurive të paluajtshme me banka të ndryshme ne Kosovë siç është banka BKT, TEB, Raiffesen Bank , KEP etj pastaj ofron dëshmi se ka bërë vlerësim te aseteve në KRU Prishtina dhe qarkullim i kësaj Ndërmarrje Publike në vitin 2019 ka qenë mbi 17 milion dhe ndërmarrja ka vlerë te aseteve mbi 110 milion Euro, pastaj OE ankues ka berë vlerësim të aseteve në KRU "Gjakova" e cila sipas raporteve të vlerësimit ka vlerë të asteve mbi 43 milion Euro dhe qarkullim mbi 5 milion euro. Lidhur me ketë kërkesë OE ankues ofron edhe raporte të vlerësimit për bankat dhe vlera e aseteve dhe vlera e qarkullimi kalon shumëfish vlerën e e kërkuar .

Si dëshmi është lista e kontratave te realizuara ku për pjesën me te madhe te kontratave te realizuar OE ankues ofron edhe referenca te cilat lehtësisht janë te verifikueshme pas qe tek lista e kontratave të

realizuara janë cekur edhe personat kontaktues përmes se cilëve mund te verifikohen kontratat e realizuara

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar ne vlerësimet e cekura Eksperti Shqyrtues i rekomandon Panelit Shqyrtues qe te mbet ne fuqi vendimi i AK-së Pasi qe dy nga tri pretendimet janë te pa bazuara.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues,- "Trainkos"SHA
- Panelit Shqyrtues - OSHP.
- OE ankues: "PRO ACC GROUP"
-